

AKT THEMELIMI

I

SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“GS Consulting” shpk

Ortaku i Vetem themelues si më poshtë:

- Z. GENTIAN SALLAKU, shtetas shqiptar, i datëlindjes 14 / 07 / 1975 , lindur në Shijak, Shqiperi, banues në Sukth, Godine private, Rruga Erzeni, Durres, me dokument identifikimi nr. 038645625 dhe kodin personal H50714003M ;

Pjesa e përgjithshme

Bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, sot me datë 02/09/2022 hartojnë këtë Akt – Themelimi si më poshtë vijon:

NENI 1

Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “GS Consulting” shpk. Ndryshimi i emërimit të Shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

NENI 2

Forma

Shoqëria tregtare “GS Consulting” shpk, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qëndrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “GS Consulting” shpk do të ketë zyrën e saj qendrore: VORE , Koder Vore, Rruga “Bashkia “ , Zona Kadastrale 2183, Njesi me Nr.pasurie 90/55, Ap.10, Kati 7.

3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të Shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

NENI 4

Objekti I veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt aktiviteti në Shqipëri dhe jashtë saj :

Sherbime të ndryshme inxhinierike, si dhe konsulencë e planifikim biznesi për kompanitë që operojnë në sektorët e agro-industrisë, bujqesise, energjise, telekomunikacionit dhe mjeteve të transportit. Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj tregëtare .

NENI 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë deri me date 31.12.2050 dhe mund të shtyhet sipas ligjeve në fuqi.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Shoqëria tregëtare " **GS Consulting** " shpk mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë " **GS Consulting** " shpk dhe mbulojnë personalisht humbjet e Shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar " **GS Consulting** " shpk është **100.000** (njëqindmije) Leke, ndarë në **1 kuote**, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga ortaku i vetem.

8.2 Ortakët kanë kontribuar në krijimin e kapitalit të Shoqërisë dhe zotërojnë kuotat e tyre në këtë mënyrë:

- **Z. GENTIAN SALLAKU** zotëron **1 kuotë**, të barabartë me **100% të kapitalit** të Shoqërisë, me vlerë **100.000 Lekë**.

NENI 9
Organet e shoqërisë

9.1 Organet e shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve
- Administratori

Detyrat e organeve të Shoqërisë do të përcaktohen në statutin e Shoqërisë.

9.2 Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë dhe shlyejnë pjesët e kapitalit të zmadhuar në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital.

NENI 10

Administratori

10.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë që emërohen dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje.

Administratoret e Shoqërisë janë dhe kanë kompetenca të panvarura si me poshtë:

- Z. GENTIAN SALLAKU është Administratori i përgjithshëm i Shoqërisë. Ai kryen veprimet e administrimit ligjor si dhe operacional, të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm.


NENI 11

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje gjykatës kompetente.

Ky Akt-Themclimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe.

ORTAKU I VETEM

GENTIAN SALLAKU



Durres me, 11 / 12 / 2023